



REPUBLICA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SER. OF KOSOVO

Pranimi / Dorezimi Primiema / Predato Received / Delivery	15.02.2021	viti god. year	1
Organ / Njesia Organ / Jednica Org. / Unit	SKOMSH/OK	Numeri i Prot. Br. Prot. / Prot. No.	630/2021
		Statuti / Protig. Appendix	
		Sasia Kolicitimi Quantity	113



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.26/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.26/2021 të datës 25.01.2021, të parashtruar nga ankuesi të cilën me autorizim e përfaqëson Studio e Avokatisë “Avokatura A-R” SH.P.K, me adresë Rr. “Egnatia”, Nr.5, Lagja Ulpiana në Prishtinë, kundër organit të punësimit/Agjencia e Statistikave të Kosovës, në çështjen juridike “ndërprerje e marrëdhënies së punës” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 15.02.2021, mori këtë:

### V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.26/2021 të datës 25.01.2021 të parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson me datë 25.01.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 283/2021 të regjistruar me numër A.nr.26/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, për shkëputjen e Kontratës – Marrëveshjes për Shërbime të Veçanta me Nr.04-052-3125 të datës 09.09.2019.



*Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokolli 283/2021 të datës 25.01.2021 të regjistruar me numër A.nr.26/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 05.12.2019; Aktgjykimin A.nr.1048/20 të Gjykatës Themelore në Prishtinë; Vendimin e datës 06.01.2021 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës; Shpalljen e konkursit publik për marrëveshje për shërbime të veçanta; Marrëveshje për Shërbime të Veçanta të datës 09.09.2019; Certifikatën e 26.10-26.11.2019; Njoftimin e datës 12.03.2019; Kontratën për kohë të caktuar të datë 01.01.2019.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është organ kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi **sepse:**

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesi me datë 09.09.2019 ka lidhur Marrëveshje për Shërbime të Veçanta me Agjencinë e Statistikave të Kosovës.

Agjencia e Statistikave të Kosovës me datë 31.12.2019 ka shkëputur në mënyrë të njëanshme Marrëveshjen për Shërbime të Veçanta, me ankuesin. Kundër vendimit për shkëputje të Marrëveshjes për Shërbime të Veçanta, ankuesi ka parashtruar padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, ku kjo e fundit më datë 17.12.2020 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.1048/20 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke e anuluar vendimin Nr.04-052-3676 të datës 31.12.2019 të Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje të e paditura - Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve Ankesave pran Agjencisë së Statistikave të Kosovës më datë 06.01.2021 ka nxjerr Vendim me Nr.04-052-02 përmes të cilit ka refuzuar ankesën e ankuesit dhe ka udhëzuar palën për ushtrimin e mjeteve juridike në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, lidhur me këtë çështje ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 12 ku përcaktohet se: *1. Në Shërbimin Civil të Kosovës ekzistojnë dy kategori të punësuarve: 1.1. pozitat e nëpunësve civilë të karrierës - të cilët ushtrojnë funksionet në baza të përhershme për arritjen e objektiveve të përgjithshme institucionale; dhe 1.2. pozitat e nëpunësve civilë të jo karrierës - të cilët ushtrojnë funksionet me kohëzgjatje të kufizuar deri në dy (2) vjet, për zbatimin e projekteve të caktuara, zëvendësimi i përkohshëm i nëpunësve të përhershëm civilë dhe në raste të mbingarkesave në punë* dhe si rrjedhojë ka konstatuar se të punësuarit me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta nuk hyjnë në asnjërën nga këto dy kategori të punësuarve në Shërbimin Civil. Kolegji, po ashtu, bazuar në nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës konstaton se të punësuarit me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta i nënshtrohen dispozitave të Ligjit për Detyrimet, dhe si rrjedhojë nuk e kanë statusin e nëpunësit civil.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, këtë konstatim e mbështet edhe në Aktgjykimin ARJ-UZVP.nr.26/2018 të Gjykatës Supreme të Kosovës i cili ndër të tjera konstaton se organi i paditur në këtë rast Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka vepruar drejt kur ka shpallur veten jo kompetent për shqyrtimin e ankesës nga fakti se kategoria e të punësuarve me kontrata konsulente (marrëveshje për shërbime të veçanta), nuk bëjnë pjesë në dy kategoritë e të punësuarve në Shërbimin Civil të Kosovës.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të vendosur vetëm për nëpunësit civil dhe kandidatet për praninë në Shërbimin civil, si dhe duke marrë parasysh konstatimin se të punësuarit me Marrëveshje për Shërbime të Veçanta nuk kanë statusin e nëpunësit civil, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.26/2021**

**Avdyll BEKTESHI,**

*Bekteshi*  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dorëzohet:**

- Përfaqësuesit të ankuesit Studio e Avokatisë "Avokatura A-R" SH.P.K;
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Statistikave të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Statistikave të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së;

